



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 23/4 prot.

Tiranë, më 30.03.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 23, datë 30.03.2026

**MBI PROCESIN E VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË PROCEDURËS SË
KONKURRIMIT PËR PLOTËSIMIN E POZICIONEVE “SPECIALIST PËR BE-
në” DHE “SPECIALIST PËR PROJEKTE”, PRANË NJËSISË PËR KOORDINIMIN
E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE, NË DREJTORINË E
BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE MARRËDHËNIEVE ME
QYTETARËT, TË SHPALLURA NGA BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Mirditë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 23 prot., datë 07.01.2026, të dërguar nga konkurrentja *Hygerta Gjonaj*, pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve “Specialist për BE-në” dhe “Specialist për Projekte”, pranë Njesisë për Koordinimin e Integritimit Europian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, kategoria e pagës IV-3, të shpallura nga Bashkia Mirditë, në përmbajtje të së cilit ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara, nga njësia përgjegjëse pranë kësaj bashkie.

Referuar përmbajtjes së informacionit të dërguar, kandidatja ngre pretendimin se ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në shpallje, për të marrë pjesë në procedurën e pranimit në shërbimin civil për të dy pozicionet e shpallura, por nuk është njoftuar nga njësia përgjegjëse nëse është kualifikuar apo jo për vijimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit.

Për këtë arsye, kandidatja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur nga njësia përgjegjëse, në lidhje me respektimin e detyrimit ligjor për njoftimin e kandidatëve gjatë fazave ndryshme të procesit të konkurrimit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga konkurrentja *Hygerta Gjonaj*, në mbështetje të kompetencave ligjore parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka nisur procesin e verifikimit të informacionit, nëpërmjet shkresës nr. 23/1 prot., datë 21.01.2026, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje verifikimin e informacionit të dërguar pranë Komisionerit me shkresën nr. 23 prot., datë 7.1.2026, të dërguar nga nëpunësja Hygerta Gjonaj*”, ka vënë në dijeni institucionin e Bashkisë Mirditë për fillimin e verifikimit të procedurës së konkurrimit, si dhe ka kërkuar dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Mirditë, me shkresën nr. 393/1 prot., datë 05.02.2026, me lëndë: “*Përgjigje në lidhje me kërkesën e Hygerta Gjonaj*”, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 23/2 prot., datë 06.02.2026, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar.

Referuar përmbajtjes së dokumentacionit të administruar, si dhe analizës së pretendimeve të ngritura nga pjesëmarrësja në procedurën e konkurrimit në fjalë, rezulton se, në lidhje me fazat e zhvilluara evidentohet kjo situatë:

a. *Faza e publikimit të vendëve të lira*: Njësia përgjegjëse pranë institucionit të Bashkisë Mirditë, në mbështetje të dispozitave ligjore në të cilat normohet instituti i rekrutimit, e konkretisht, të neneve 20 deri 25, të kreut IV, “*Pranimi në shërbimin civil*”, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, ka shpallur procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve “*Specialist për BE-në*” dhe “*Specialist për Projekte*”, pranë Njesisë për Koordinimin e Integritit European dhe Projekteve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët. Me shkresën nr. 3460/1 prot., datë 29.08.2025, të Kryetarit, janë dërguar për publikim pozicionet e lira, në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Aftësive*” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit.

Nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se, shpallja e vendit të lirë i përmban të dhënat e kërkuara në pikën 9, të kreut II, të aktit nënligjor në fjalë, me përjashtim të specifikimit të kriterit arsimor dhe nivelit të diplomës në fushën që duhet të zotërojnë

kandidatët. Në shpallje është parashikuar që për fazën e lëvizjes paralele kandidatët duhet “...të zotërojnë së paku *Diplomë të nivelit Bachelor, në Shkenca Juridike, Gjuhë të Huaja, Shkenca Shoqërore, Ekonomike...*”, ndërsa për fazën e pranimit në shërbimin civil kandidatët duhet “*Të jetë diplomuar, minimumi niveli “Bachelor”, në Shkenca Juridike/Shkenca Sociale/Shkenca Filologjike/Gjuhë të Huaja...*”.

Në këtë fazë të procesit, konstatohet se, përcaktimi i fushës së arsimit është i gabuar në përdorimin e termave, pasi nuk ka një kuptim të saktë të ndarjes së profileve të studimit sipas fushës së shkencës ku përfshihen.

Referuar metodologjisë së ndarjes së degëve sipas fakulteteve rezulton se, Shkencat Ekonomike, Gjuhët e Huaja dhe Filologjiku, bëjnë pjesë tek kategoria e “*Shkencave Shoqërore*” dhe nuk janë shkencë të ndara më vehte.

Në këto kushte, njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes gjatë hartimit të shpalljes së pozicionit vakant dhe përcaktimit të kërkesave, në proceset në vijim, sa i takon llojit të edukimit arsimor që duhet të zotërojnë kandidatët, duke pasur në vëmendje, kërkesat e arsimit të vendosura në përshkrimin e punës për pozicionin vakant, ku fusha e arsimit duhet të jetë e përcaktuar saktë.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit duhet të zbatojë rregullat e përcaktuara në udhëzimin nr.1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, në lidhje me kriteret specifike për çdo pozicion pune, (*arsimin dhe vjetërsinë*).

Konfuzioni si në rastin që po vlerësojmë, passjell probleme në fazën e verifikimit të kandidatëve që i plotësojnë kriteret për të vijuar konkurrimin.

b. *Faza e parë e konkurrimit, për lëvizjen paralele:* Përsa i përket fazës së parë të konkurrimit për lëvizje paralele, e cila është mbyllur pa kandidatë pjesëmarrës, njësia përgjegjëse ka dërguar njoftimin për publikim në AKPA, me shkresën nr. 3460/4 prot., datë 17.09.2025, të Kryetarit. Në këto kushte, procedura e konkurrimit ka vijuar me fazën e dytë, pranim në shërbimin civil.

c. *Faza e dytë e konkurrimit, për pranimin në shërbimin civil:* Në vijim të analizës së bazës ligjore të këtij procesi rezulton se, në pikën 1, kreu IV, “*Konkurrimi*”, të vendimit nr.243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, parashikohet se konkurrimi përfshin dy faza, të cilat janë: *i)* verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe *ii)* vlerësimi i kandidatëve.

i. *Verifikimi paraprak i kandidatëve pjesëmarrës në fazën e pranimit në shërbimin civil:* Në zbatim të germës a), të pikës 2, kreu IV, të aktit nënligjor në fjalë, njësia përgjegjëse e institucionit, ka kryer verifikimin paraprak të kandidatëve pjesëmarrës në fazën e pranimit në shërbimin civil, për plotësimin e të dy pozicioneve, në përfundim të

së cilit, për pozicionin “*Specialist për BE-në*”, pranë Njesisë për Koordinimin e Integrimit Europian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, janë kualifikuar për fazën e testimit me shkrim, kandidatet Hygerta Gjonaj dhe Vitore Macaj, ndërsa për pozicionin “*Specialist për projektet*”, pranë Njesisë për Koordinimin e Integrimit Europian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, është kualifikuar vetëm një kandidate, Greta Reçi.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatja H. Gjonaj, lista e dokumentave dhe CV-ja, rezulton se kandidatja ka aplikuar duke dorëzuar dokumentacion përkatës, për të dy pozicionet e punës “*Specialist për BE-në*” dhe “*Specialist për projektet*”. Pas verifikimit paraprak të kandidatëve pjesëmarrës në fazën e pranimit në shërbimin civil, rezulton se, njësia përgjegjëse **nuk e ka kualifikuar kandidaten** për pozicionin “*Specialist për projektet*”, pranë Bashkisë Mirditë **edhe pse ajo i plotësonte kërkesat e pozicionit të shpallur**, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Nga ana tjerër, nuk konstatohet asnjë dokument që të provojë se kjo kandidate është s’kualifikuar, për ndonjë arsye të përligjur.

Konstatohet se, nëpunësja H. Gjonaj, nuk është përfshirë në listën e shpallur për kandidatët fitues edhe për pozicionin “*Specialist për projektet*”. Ky veprim vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit, pasi Njësia përgjegjëse, arbitrarisht nuk e ka publikuar emrin e kandidates në fjalë në listën e fituesve.

ii. Publikimi i kandidatëve të kualifikuar: Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se, njësia përgjegjëse e institucionit, sipas pikës 3, të kreut IV, të VKM-së nr.243, datë 18.03.2015, e ndryshuar, ka renditur kandidatët e kualifikuar, për secilin pozicion dhe në mbështetje të germës b), pika 4, kreu IV, të këtij akti nënligjor, lista është dërguar për publikim pranë AKPA-së, nëpërmjet shkresës nr. 3460/5 prot., datë 24.09.2025, të Kryetarit. Nga verifikimi i faqes zyrtare të institucionit, rezulton se megjithëse lista është publikuar në AKPA, ajo **nuk është publikuar** si në këtë faqe, ashtu edhe në stendat e informimit të publikut, të cilat janë forma të detyrueshme publikimi të parashikuara në këtë dispozitë të VKM-së.

Referuar dokumentacionit ku materializohet procedura e konkurrimit, rezulton se, në shpalljen e publikuar për pozicionet vakante, është përcaktuar se afati i shpalljes së rezultatit për fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve do të jetë data **19.09.2025**, ndërkohë që, në fakt, shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak pranë AKPA-së, është publikuar në datën **24.09.2025**, jashtë afatit të përcaktuar në shpallje.

Në këtë rast, nuk evidentohet asnjë njoftim i njësisë përgjegjëse, drejtuar kandidatëve që kanë aplikuar për këtë procedurë konkurrimi për shtyrjen e afatit, duke bërë të pamundur njohjen e tyre me këtë fakt.

Në përfundim të analizës së fakteve të parashtruara më sipër, konstatohet se, mosrespektimi i afateve të publikimit të listës së kandidatëve të kualifikuar nga njësia përgjegjëse, për të vijuar më tej fazat e konkurrimit, si edhe arbitrariteti për të mos përfshirë konkurrenten H. Gjonaj, në listat fituese për pozicionin “*Specialist për projektet*”, i ka mohuar të drejtën për të marrë pjesë në konkurrim dhe për pasojë, për tu zgjedhur në pozicionin e punës për të cilin është shpallur konkurrimi.

Sa më lart, arrihet në konkluzionin se, procedura e konkurrimit e zhvilluar për plotësimin e dy pozicioneve të punës “*Specialist për BE*” dhe “*Specialist për Projekte*”, pranë Njesisë për Koordinimin e Integritit European dhe Projekteve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënive me Qytetarët, të shpallur nga Bashkia Mirditë, duhet të përsëritet, nga faza ku kanë filluar parregullsitë e konstatuara, në mbështetje të nenit 109, germa b), të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”. Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 114, të këtij kodi, duhet të shfuqizohet akti i emërimit të fituesit nga vetë organi që e ka nxjerrë atë dhe të vijojë procesi i konkurrimit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të nenit 109, germa b) dhe nenit 114, pika 1 dhe 2, e ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Bashkisë Mirditë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Kryetari i Bashkisë Mirditë, si dhe njësia përgjegjëse duhet të shfuqizojnë aktin e emërimit të kandidatëve fitues për plotësimin e pozicioneve “*Specialist për BE*” dhe “*Specialist për Projekte*”, pranë Njesisë për Koordinimin e Integritit European dhe Projekteve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënive me Qytetarët, kategoria e pagës IV-3, pranë Bashkisë Mirditë.
2. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Mirditë duhet të përsërisë procedurën e konkurrimit, duke nisur nga faza e verifikimit të kandidatëve me qëllim që ato të plotësohen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore që normojnë institutin e rekrutimit në shërbimin civil.

3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **1** muaj, nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, institucioni i Bashkisë Mirditë të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Mirditë, si dhe kërkuesja Hygerta Gjonaj.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)